

RAPORTI VJETOR

2021



Përgatiti Raportin:

*Shpresa BANJA; Nertila TOLI; Dhoksi GJOKA; Mirela GJONI; Soela KURTI;
Gertjana HASALLA; Valmira PAJENGA*

Janar, 2021

Gjatë vitit 2021 FGE ka zbatuar këto projekte:

1. Ka vazhduar dhe për vitin 2021 zbatimi I projektit “Akses I përmirësuar për Gratë dhe Vajzat të mbijetuara të dhunës në Qarkun e Elbasanit”/ “Improved access for women and girls survivors of violence in Elbasan Region” Ky projekt ka filluar të zbatohet në 1 Shtator 2018 deri më 31 Gusht 2021 me mbeshtetjen e UN Women përmes UNTF (Fondi I Besimit I Kombeve të Bashkuara) dhe 1 Janar 2019 deri me 31 Dhjetor 2021 është Financuar nga AWEN/Sida (Rrjeti Kombëtar Fuqizimit të Gruas në Shqipëri). Per vitin 2021 UNTF ka kontribuar me vlerën 39,050 \$ dhe AWEN me vlerën 30 000 Euro.
2. “Sfidimi i normave ekzistuese shoqërore përmes fushatave ndërgjegjësuese midis komuniteteve shkollore mbi stereotipet e dëmshme gjinore që përjetësojnë të gjitha format e VAWG-së, në veçanti dhunën seksuale, ngacmimin, ndjekjen dhe martesën e detyruar. “Challenging existing societal norms through awareness-raising campaigns among school communities on harmful gender stereotypes that perpetuate all forms of VAWG, in particular sexual violence, harassment, stalking and forced marriage” me mbwshtetjen e UNWomen në vlerën me fondet e 39845 \$.
3. “Akses i përmirësuar në shërbimet juridike dhe psikologjike dhe informacionin mbi ndihmën juridike falas për gratë dhe vajzat në të gjithë rajonin e Elbasanit, Rrogozhinës dhe Kavajës deri në Nëntor 2022”/“Improving the access to legal and psychological services and information on free legal aid to women and girls all over the Region of Elbasan, Rrogozhina and Kavaja until November 2022” me mbwshtetjen e UNWomen në vlerën me fondet e 7,629,800 All
4. “Partneriteti mes Policisë së Shtetit, aktorëve lokal dhe komunitetit në lidhje me Dhunën në Familje dhe Dhunën me Bazë Gjinore në Bashkinë Belsh, Gramsh, Peqin dhe Librazhd”

Veprimtaria e Forumit të Gruas Elbasan (FGE) edhe gjatw vitit 2021 është fokusuar në tre shtylla kryesore si më poshtë:

- a) Shërbime konkrete në favor të grave dhe vajzave;
- b) Fushata sensibilizuese;
- c) Trajnime dhe ngritje kapacitetesh.

a. Shërbime

Shërbimet konkrete për gra/vajza me probleme dhune realizohen nga:

1. **Qendra e Këshillimit**, ofron shërbime falas në ndihmë të grave/vajzave me probleme dhune dhe social-ekonomike në Qarkun e Elbasanit, por edhe nga Qarqet e tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shërbimet e ofruara nëpërmjet psikologes/punonjësese sociale, janë:

- Mbështetje psikologjike, sociale, individuale dhe në grup;
- Ndërmjetësim me familjarët dhe përfituesit për gjetjen e alternativave drejt zgjidhjes së problemeve;
- Ndërmjetësim në qendrën e Formimit Profesional, në Biznesin Lokal;
- Informim, orientim dhe referim të rasteve për shërbime të tjera alternative të nevojshme të ofruara nga aktorë të tjerë vendor (publikë dhe jopublikë).

Gjatë periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor 2021 në total janë ofruar keto këshillime psikologjike, nga këto:

- **271 këshillime nëpërmjet linjës telefonike**, ku nëpërmjet numrit të telefonit +355 69 65 11 674 përfitueset prezantojnë problemet e tyre duke mbetur anonim.
- **546 këshillimit ballë për ballë**, ku vajzat/gratë vijnë direkt në Qendrën e Këshillimit dhe bëjnë prezente problemet dhe shqetësimet e tyre.
- **213 pyetësorë** të plotësuar nga përfitueset për të identifikuar nevojat e tyre, në strehim, punësim etj.

2. **Studio Avokatore** ofron shërbim ligjor falas. Shërbimet më konkretisht janë si më poshtë:

- **453 konsulenca ligjore** me objekte të ndryshme. Këto konsulenca u janë ofruar përfitueseve që kanë dashur të marrin vetëm informacion ligjor;
- **68 dosje ligjore** të çelura për përfaqësim në gjykatë;
- **70 akte ligjore** të hartuara për procesin gjyqësor dhe kërkesa drejtuar institucioneve të tjera.
- **323 konsulenca ligjore** brenda dosjeve ofruar para dhe pas seancave gjyqësore;
- **116 përfaqësime** në gjykatë me avokat.


3. Qendra e Kujdesit Ditor ose Strehëz Emergjence) është e vetmja në gjithë Qarkun Elbasan. Kjo qendër lindi si nevojë e asistimit dhe mbështetjes së grave të dhunuara të cilat denoncojnë dhunuesit e tyre, janë në rrezik e kërkojnë të pajisen me Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe Urdhërit të Mbrojtjes. Që nga Shtratori 2021 dhe deri me 30 Prill 2022 kjo strehëz u mbështet nga UNDP dhe koha e qëndrimit në këtë strehëz u rrit deri në marrjen e një Urdhëri Mbrojtje që ligjërisht kërkon 15 ditë . Në Dhjetor 2021 për herë të parë mbas 10 funksionimi të kësaj strehëze qeraja u mbështet nga Bashkia Elbasan dhe do të vazhdojë mbështetja për një periudhë trevjecare sipas deklarimeve të bëra nga kryetari i bashkisë në media të ndryshme sociale. Kontrata e nënshkruar ndërmjet dy institucioneve FGE-Bashki përfundon në Gusht 2022

Shërbimet e ofruara nëpërmjet strehëzës janë:

1. Strehim nga disa orë deri në 5 apo 15 ditë, në pritje të marrjes së Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhërit të Mbrojtjes, për vajza/gra dhe fëmijët e tyre nën 18 vjeç.
2. Vazhdim i këshillimit psiko-social-ligjor e mjekësor nga QK dhe SA-ja gjatë ditëve të akomodimit.

Gjatë vitit 2021 në QKD janë akomoduar **32 gra/vajza** dhe **33 fëmijë** të grup moshave të ndryshme.

17 raste kanë qenë nga Bashkia Elbasan, 6 nga Bashkia Librazhd, 3 nga Bashkia Peqin, 3 nga Bashkia Prrrenjas dhe 2 nga Bashkia Cërrik, Një rast ka qenë nga Bashkia Kavajë dhe një rast tjetër nga Bashkia Tiranë



Aktivitete të tjera përveç sa më sipër bëra në kuadër të projektit të mbështetur nga UNTF dhe të zbatuar gjatë vitit 2021:

Tavolina e rrumbullakët me të gjithë aktorët lokalë për të bërë prezent gjetjet nga monitorimi tre vjeçar i :

Gjykatës së rrethit Gjyqësor Elbasan për periudhën:

- 1 Dhjetor 2018-28 Shkurt 2019
- 1 Dhjetor 2018-28 Shkurt 2019
- 1 Dhjetor 2018-28 Shkurt 2019

Medias në lidhje me çështjet që ka trajtuar për dhunën dhe dhunën me bazë gjinore në Qarkun Elbasan. Periudha që është monitoruar është:

- 1 Dhjetor 2018-28 Shkurt 2019
- 1 Dhjetor 2018-28 Shkurt 2019
- 1 Dhjetor 2018-28 Shkurt 2019

7 bashkive dhe 50 Njësive Administrative në vartësi të tyre në lidhje si kanë zbatuar detyrimet ligjore për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore mbasi janë paisur me një UrdhërMbrotje (UMM/UM) nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Periudha e realizimit të monitorimit është;

- 1 Mars 2019-31 Maj 2019
- 1 Mars 2020-31 Maj 2020
- 1 Mars 2021-31 Maj 2021

Ky monitorim është bërë tre muaj më vonë me qëllim që mbasi të merreshin të dhënat e Gjykatës të monitoronimin si Bashkitë kanë zbatuar detyrimet ligjore për pagesën UM në vlerën 3000 All për të mbijetuarat e dhunës të paisur me UMM apo UM.

Takimi u organizua në ambjentet e Real Scampis me datë 30 Korrik 2021. Për këtë arsye shpërndamë ftesat që institucione publike dhe jo publike, media, etj. Një kopje e saj më poshtë.

Forumi i Gruas Elbasan (FGE) ju fton të merrni pjesë në **tryezën e rrumbullakët** për prezantimin e raportit të gjetjeve të monitorimit tre-vjeçar 2018 – 2021 të realizuar në kuadër të projektit “*Akses i përmirësuar për gratë dhe vajzat të mbijetuara të dhunës në Rajonin e Elbasanit*” i financuar nga UN Women nëpërmjet United Nations Trust Fund. Projekti synon të reduktojë Dhunën në Familje (DHF) dhe Dhunën me Bazë Gjinore (DHBGJ) për gratë dhe vajzat të mbijetuara të dhunës në Rajonin e Elbasanit për periudhën Shtator 2018 - 2021.

Qëllimi i kësaj **tryeze të rrumbullkët** ishte prezantimi i raportit të gjetjeve dhe rekomandimeve në lidhje me monitorimin e kryer të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, 7 Bashkive të Qarkut Elbasan dhe Mediave lokale vizive dhe të shkruara të realizuar përgjate tre viteve (2018 – 2021).

Rezultatet e këtij monitorimi treguan qartazi se si institucionet gjyqësore, njësitë e qeverisjes vendore dhe mediat funksionojnë, ofrojnë shërbime dhe japin informacione sensitive në lidhje me çështjet e DHF, DHBGJ dhe barazisë gjinore.

Takimi do të mbahet në datën **30 Korrik 2021, ora 10:30**, në sallën e **Real Skampis Elbasan**.

Ju mirëpresim!



Foto nga tavolina 30 Korrik 2021

Në bazë të këtyre gjetjeve u përgatit një raport monitorimi I cili qëndroi për 15 ditë në të gjithë mediat sociale të FGE dhe me pas u bë botimi I këtij raporti.

Link post Web: http://www.forumigruaselbasan.org/blog/fge_publicimi-i-raportit-te-gjetjeve-te-monitorimit-2018-2021-untf/

Direct link web; http://www.forumigruaselbasan.org/wp-content/uploads/2021/08/FGE_Raporti-i-Gjetjeve-te-Monitorimit-UNTF_2018-2021-1.pdf

Facebook: <https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2852211371707966>


Twitter: <https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1422889215881322501>

Me gjetjet kryesore të raportit, FGE përgatiti një shkresë zyrtare dhe ja dërgoi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Cështjeve Sociale për ti marrë në konsideratë.

1. Të hiqet trajtimi i të mbijetuarave të dhunës në familje nga legjislacioni aktual në fuqi si: Ligji 57/2019 datë 18.07. **“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”** dhe VKM Nr 597 datë 04/09.2019 **“Për caktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”** dhe të trajtohet në një legjislacion të ri specifik vetëm për raste të tilla;
2. Një e mbijetuar e dhunës në familje e cila/cili është në skemën e ndihmës ekonomike të mos i ndërpritet pagesa si familje në nevojë dhe për dhunën e pësuar të marrë dhe pagesën në vlerën 3000 All për kohën e plotë të përcaktuar në vendimin e Gjykatës (identik si rasti kur një e mbijetuar e dhunës në familje është e punësuar dhe i merr të dyja);

3. Përfitimi i plotë i gjithë periudhës së vlefshmërisë së Urdhrit të Mbrojtjes (Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, Urdhrit të Mbrojtjes) për çdo viktimitë të njohur nga çdo Gjykatë në Shqipëri;
 4. Përfitimi i Urdhrit të Mbrojtjes (Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, Urdhërit të Mbrojtjes) edhe nëse një e mbijetuar është në Shqipëri apo jashtë saj;
 5. Depozitimi i pagesës së Urdhrit të Mbrojtjes (Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, Urdhrit të Mbrojtjes) pranë Bankave të ndyshme dhe jo dërgimi i tyre me postë;
 6. Të mos i ndërpritet vlera e Urdhrit të Mbrojtjes (Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, Urdhrit të Mbrojtjes) edhe nëse e mbijetuara punësohet gjatë kësaj periudhe; Bazuar në legjislacionin në fuqi (mbi të cilin funksion dhe sistemi elektronik i skemës së NE-së), pagesa e NE-së (UM/UMM) nuk ndërpritet për arsye punësimi të personit, POR nëse personi nuk deklaron të dhënat mbi faktin e punësimit të tij, atëhere përjashtohet nga skema për arsye “Deklarimi të rremë”. (Baza ligjore VKM nr.597.2019: pika 11 e Kreut II).
 7. Të shikohet mundësia e dyfishimit të pagesës për çdo viktimitë dhune në familje të njohura nga Gjykata nga 3000 ALL në 6000 ALL;
 8. Të zbatohet pika 6 e Nenit 23 e Ligjit “Për masa ndaj dhunës në mardhëniet familjare” i ndryshuar i cili thotë: Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji dhe/ose në vendimin e gjykatës, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes.
- ✚ **3 sesione fuqizimi** për vajzat dhe gratë të mbijetuara të dhunës janë mbajtur me qëllim fuqizimin e tyre dhe dhënien e informacionit mbi çështje të lidhura punësimin, strehimin, të drejtat pronësore dhe ndihmën ekonomike. **63** përfituese të shërbimeve të FGE kanë qënë pjesë e këtyre sesioneve për të thyer ciklin e dhunë sdhe për tu ri-integruar në shoqëri. Për shkak të konfidencialitetit të grave/vajzave nuk realizohen apo publikohen fotografi të sesioneve.

- ✚ Për ti ardhur në ndihmë viktimave të dhunës në familje sipas problematikave të ngritura nga ato, gjatë këtij viti janë realizuar 3 **Rrjete Rajonale** me pjesëmarrjen e aktorëve lokal nga gjithë Qarku Elbasan. Për shkak të situatës së COVID 19 Rrjeti i parë Rajonal i këtij viti u bë online



25.02.2021



28.05.2021



30.07.21

Ngjarja me kulmante në vitin 2021 ishte Konferenca “22 minuta për 22 vite” që stafi I FGE organizoi në Teatrin Skampa Elbasan. Një pjesmarrje e madhe, përfaqësues nga të gjithë institucionet publike, Bashkitë, Policia, Gjykata, Prokuroria, Universiteti, perfituese të shërbimeve të FGE dhe vullnetare të FGE. Në këtë konferencë patëm përfaqësimin e dy ministrave me dy Z/Ministrat, Znj. Nina Guga Dhe Z. Albert Nikolla E para Z/Ministre e Arsimit dhe Sportit dhe I dyti Z/Minister I Ministrise së Shëndetësisë dhe Çeshtjeve Sociale, si dhe Znj Alma Katragjini përfaqësuese e Ministrisë së Brendëshme, me të cilat FGE ka bashkëpunuar në këto vite.





Holli i Teatrit SKAMPA



Në këtë Konferencë ishin të pranishëm gjithashtu: Znj. Elsa Hastad Ambasadore e Suedisë në Tiranë. Qeveria Suedeze është donatori Strategjik për FGE pasi ka filluar të financojë shërbimet e FGE që nga viti 2002 e deri më sot në mënyrë të pandërprerë Znj Fiona McCluney Kordinator I Përyjshëm I UN në Shqipëri. Të ftuara nderi në këtë Konferencë ishte Znj. Diana Çuli shkrimtare e mirnjohur dhe Presidente e Forumit të

Pavarur të Gruas Shqiptare dhe Znj Ines Leskaj, Drejtore Ekzekutive e rrjetit te Fuqizimit të Gruas Shqiptare AWEN, ku FGE është antare prej vitesh Në këtë konferencë Kryetari I Bashkisë Elbasan i akordoi FGE emimin e mirnjohjes së qytetit.

<https://www.facebook.com/ljatja.gledian/posts/439629697534487>

<https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2925591904369912>

Konferenca u drejtua nga Z. Eduart Çala, aktor dhe regjizor i mirënjohur në Teatrin SKAMPA. Në këtë konferencë u nderuan “Kampionët e Ndryshimit” të cilët në jetën e tyre të përditëshme ndihmojnë gratë/vajzat me probleme të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore. Konkretisht: Z. Ylli Salla nga Drejtoria e Vendore e Policisë Elbasan, SPZ që bashkëpunon shumë ngushtë me FGE në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje sidomos në momentin që e mbijetuara e denoncon dhunën dhe kërkon në polici hartimin e kërkesë padisë për një Urdhër Mbrojtje. Z. Agim Hajdari shef I Burimeve Njerezore pranë Kompanisë “Fenix shpk” Z.Hajdari cdo grua/vajzë me probleme dhune që punon në kompaninë Fenis shpk e shoqëron direkt në ambjentet e FGE për ta mbështetur emocionalisht apo ligjërisht. Znj Natasha Meçe me profesion infermiere, gjithashtu identifikon gratë/vajzat me probleme dhune në Njësinë Administrative Shalës dhe në zbatim të detyrimeve ligjore si punonjëse e strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë I orienton të mbijetuarat drejt FGE për të përfituar shërbimet e nevojshme, Znj. Xhoana Kila që dy herë në institucion ku punon ka ngritur fonde për të mbështetur të mbijetuarat e dhunës në familje, ABI Bank pasi është institucioni I parë bankar në Shqipëri që mbështeti disa të mbijetuara dhe Strehëzën e Emergjencave që menaxhohet nga FGE.

Dokumenta në YouTube: <https://www.youtube.com/watch?v=cccYVJSWuvc>

Facebook:

<https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2923285284600574>

<https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2924716917790744>

<https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2925321611063608>

<https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2926072337655202>

<https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2926081687654267>

Twitter:

<https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1448264914385129475>

<https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1460202756732502023>

<https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1460953741994172416>

<https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1461350132155240455>

<https://twitter.com/unwomenalbania/status/1461349117787979797>

<https://twitter.com/ForumiGruasElba/status/1461402052140093455>

<https://twitter.com/ForumiGruasElba/status/1461661541191888899>

<https://twitter.com/ForumiGruasElba/status/1462802878238793744>

<https://twitter.com/EHstad/status/1461351131771125767>

YouTube links lokal media:

TV Skampa: <https://www.youtube.com/watch?v=j7TCRVSMKOQ>





Best Channel Elbasan: <https://www.youtube.com/watch?v=ELVKzaPr9O4>






FGE gjatë vitit 2021 ka zhvilluar shumë takime vullnetarisht me nxënës të shkollave të mesme dhe studentë të Universitetit Aleksandër Xhuvani. Jane organizuar 4 leksione të hapura ku kanë marrë pjesë 170 studentë nga të cilët 134 vajza dhe 36 djem. Një falenderim për Znj. Zamira Cabiri z/Dekane e Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti Aleksandër Xhuvani për angazhimin dhe kontributin e saj në këto leksione me studentë. Këto studentë nesër do të jenë infermierët e ardhshëm dhe kanë detyrime ligjore për të identifikuar të mbijetuarat e dhunës, për ti ndihmuar dhe për ti orientuar drejt shërbimeve.







Takime me sudentë

Tabela me takimet e organizuara në shkollat e mesme

Data	Total	Takime në shkolla të mesme 2021				Emri i shkolles
		Foto	Vajza	Djem	Mosha	
31.05.21	17		13	4	16-17	Vasil Kamami
31.05.21	13		6	7	16-17	Vasil Kamami
31.05.21	12		9	3	16-17	Vasil Kamami
31.05.21	12		6	6	16-17	Vasil Kamami

22.10.2021	26		19	7	17-18	Dhaskal Todri
05.11.2021	20		15	5	17-18	Vasil Kamami
24.11.2021	17		15	2	17-18	Vasil Kamami
25.11.2021	32		25	7	14-18	Luigj Gurakuqi
25.11.2021	20		14	6	14-15	Jorgji Dilo

01.12.2021	20		15	5	16-17	Mahir Domi
02.12.2021	26		20	6	17-18	Kostandin Kristoforidhi
03.12.2021	19		14	5	15-18	Shkolla mesme Prrenjas
13.12.2021	27		19	8	12-13	Sule Harri
15.12.2021	20		13	7	12-13	Belsh

Disa nga aktivitetet më kryesore të zhvilluara në kuadër të projektit: “Akses i përmirësuar në shërbimet juridike dhe psikologjike dhe informacionin mbi ndihmën juridike falas për gratë dhe vajzat në të gjithë rajonin e Elbasanit, Rrogozhinës dhe Kavajës deri në Nëntor 2022”

Sesion informues me gra/vajza

Gjate vitit 2021 është zhvilluar një sesion me pjesëmarrjen e 18 grave dhe vajzave nga Prrenjasi me datë 9.12.2021 në sallën e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Prrenjas. Ku një falenderim shkon për kryetarin e kësaj bashkie Z. Nuredin Belba. Këto sesione kanë si

qëllim të informojnë më mirë gratë dhe vajzat vecanërisht në zonat rurale, për ligjet në fuqi në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe të drejtat e tyre për ndihmë juridike falas dhe aksesin në drejtësi.



Trajnim me studentë të juridikut 15 Dhjetor 2021

Trajnimi i 17 studentëve të Fakultetit Juridik në universitetin “Aleksander Xhuvani” Elbasan. Trajnimi u zhvillua nga avokatja i FGE-së me përvojë shumëvjeçare në fushën ligjore. Fakulteti i Drejtësisë është një fakultet i sapohapur në universitetin e Elbasanit, ky trajnim do t'u ofrojë studentëve mundësinë për të rritur kapacitetet e tyre, për të ndjekur punën e një avokati me përvojë dhe të eksperimentojnë ofrimin e ndihmës juridike falas për komunitetet e marginalizuara. Gjithashtu ky trajnim do të ndikojë në rritjen e aftësive të studentëve, në mënyrë që të ofrojnë kontributin e tyre vullnetar për të rritur aksesin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë, veçanërisht për grupet në nevojë.

Disa nga çështjet kryesore të trajtuara në trajnim ishin:

- ✓ Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- ✓ Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga OJF-të;
- ✓ Plotësimi i formularëve të ndihmës juridike parësore
- ✓ Aspekte të zbatimit të nenit 52 dhe 53 të Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”;
- ✓ Arritje dhe sfida në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe ligjit nr. 125/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar;
- ✓ Kodi penal i ndryshuar;
- ✓ Kodi i familjes i ndryshuar;
- ✓ VKM nr.597 dt.04/09/2019, në zbatim të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;

- ✓ Legjislacioni shqiptar mbi të drejtën për përfitim të detyrimit ushqimor për fëmijët apo formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes dhe probleme të zbatimit të tij në praktikë.
- ✓ Cështje të diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore në marrëdhëniet e pronësisë.



Për më shumë informacionin shikoni në mediat sociale më poshtë:

Facebook; <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2943965029199266>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiGruasElba/status/1471147259257626626>

Projekti “Sfidimi i normave ekzistuese shoqërore përmes fushatave ndërgjegjësuere midis komuniteteve shkollore mbi stereotipet e dëmshme gjinore që përjetësojnë të gjitha format e VAWG-së, në veçanti dhunën seksuale, ngacmimin, ndjekjen dhe martesën e detyruar.

Ishte një projekt shumë i rëndësishëm për FGE pasi në sajë të tij, FGE shtriu shërbimin psiko/sociaal në të shtatë Bashkitë e Qarkut Elbasan me qëllim që një e mbijetuar e dhunës të mos vinte deri në Elbasan por ti përfitonte shërbimet në teritorin e Bashkisë ku ajo jetonte. Procesi filloi me përzgjedhjen e psikologe/punonjësve sociale në çdo bashki. FGE në çdo fazë bashkëpunoi ngushtësisht me Bashkitë Gramsh, Peqin, Belsh, Cërrik, Librazhd, Prrenjas që në fazën e përzgjedhjes së stafit më pas në akomodimin e tyre me ambiente dhe mjete pune pranë Bashkisë dhe paisjes më pas nga ana e FGE me kompjutera dhe kancelari.



Stafi I FGE në vitin 2021

Disa nga aktivitetet më kryesore të realizuara gjatë vitit 2021 ishin:

Ëorkshop një ditor në do bashki me profesionistët lokalë të 7 bashkive të Qarkut të Elbasanit. Disa nga ceshtjet kryesore të trajtuara në workshop:

Baza Ligjore

- Ligji nr. 125/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
- VKM, Nr. 334, datë 17.2.2011, për ngritjen e Mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij.
- Monitorimi i UMM/UM/UMPMM – në nivel Bashkie.
- Urdhërat e Mbrojtjes/ Urdhërat e Menjëhershëm të Mbrojtjes/ Urdhri për Masa Paraprake të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Çfarë është një UM/UMM/UMPMM ;

- Ushtrim, çdo pjesëmarrës do të plotësojë një UMM për të parë nivelin e njohurive dhe vështërsive për plotësimin e tij;
- Feedback mbi plotësimin e UMM nga pjesëmarrësit.
- Ofrimi i një modeli tip mbi plotësimin e një UMM-je (në nivel bashkie)

Menaxhimi I rasteve të dhunës

- Identifikimi I rasteve të dhunës,
- Referimi I rasteve tek institucionet dhe aktorët lokal,
- Menaxhimin e suksesshëm të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje,

Punë në grup: Pse profesionistët mund të dështojnë në dhënien e ndihmës një të mbijeuare dhune në familje

- Aspektet Sociale të dhunës në familje



Workshop me profesionistët locale Belsh 24.02.2021

Workshop Belsh

Facebook: <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2740943366168101>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiguasElba/status/1364648730016837635>



Workshop me profesionistët lokalë Librazhd 27.01.2021

Workshop Librazhd

Facebook: <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2722316101364161>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiguasElba/status/1354508397165608961>



Workshop në Prrrenjas me profesionistët lokalë 03.02.21

Facebook: <https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2726743177588120>

Twitter: <https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1356977128273813505>

Trajnim me punonjësit e ndihmës ekonomike Elbasan



04.03.2021 Workshop Elbasan

Workshop Elbasan

Facebook: <https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2746177182311386>

Twitter: <https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1367506299886436356>

Një komponent shumë i rëndësishëm i projektit të UNWomen ishte dhe trajnimi i profesionistëve lokalë si punonjësit e ndihmës ekonomike, infermierët dhe SPZ në nivel Qarku, konkretisht në Elbasan, në Librazhd (Librazhd/Prrrenjas), në Cërrik/Gramsh/Belsh/Peqin). Më poshtë është axhenda:

Agjendë

Sesion Trajnues "Sfidimi i normave ekzistuese shoqërore përmes fushatave ndërgjegjësuese midis komuniteteve shkollorë mbi stereotipet e dëmshme gjinore që përjetësojnë të gjitha format e DHBGJ, në veçanti dhuna seksuale, ngacmimet, përndjekja dhe martesat e detyruara"

*Vendi: Salla tek Qendra Kulturorë e Fëmijëve
Në Elbasan është bërë në sallën e këshillit të qarkut Elbasan
Në Cërrik është bërë tek salla e Këshillit Bashkiak Cërrik*

10:00 – 10:10	Regjistrimi i pjesëmarrësve / Mirëseardhja
10:10 - 11:00	Moderatore Znj. Shpresa Banja Znj. Dhoksa Gjoka

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji nr.9669 datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar); 2. VKM,Nr.327, datë 02.06.2021, për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës; 3. LIGJ Nr. 57/2019 për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë 4. VKM 597 datë 04.09.2019 Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike
11:00 – 12.00	Menaxhimi i rasteve të dhunës
	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i rasteve të dhunës, • Referimi i rasteve tek institucionet dhe aktorët lokal, • Menaxhimin e suksesshëm të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, • Punë në grup: Pse profesionistët mund të dështojnë në dhënien e ndihmës një të mbijetuare dhune në familje
12:00 - 13:30	Dreka



14.12.2021 Trajnim i punonjesve të ndihmës ekonomike Elbasan



15.12.2021 Trajnim I punonjësve të ndihmës ekonomike Librazhd -Prenjas



16.12.2021 Trajnimi i punonjësve të ndihmës ekonomike C.Gr, B dhe Pe



25.02.2021 Punonjësit e ndihmës ekonomike Cërrrik

Axhenda e trajnimit **Baza Ligjore**

5. Ligji nr.9669 datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar);
6. VKM,Nr.327, datë 02.06.2021, për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës;
7. LIGJ Nr. 57/2019 për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë;
8. VKM 597 datë 04.09.2019 Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike

Menaxhimi I rasteve të dhunës:

- Identifikimi i rasteve të dhunës,
- Referimi i rasteve tek institucionet dhe aktorët lokal,
- Menaxhimin e suksesshëm të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje,

Punë në grup: Pse profesionistët mund të dështojnë në dhënien e ndihmës një të mbijetuare dhune në familje

Në kuadër të këtij projekti u mbajtën **7 Sesioneve Informues** me oficerët e sigurisë në shkolla, psikologët e shkollave dhe mësuesit duke u përqëndruar në detyrimet për të raportuar dhunën dhe për të trajtuar rastet e të rinjve që paraqesin çështje dhune tek autoritetet përkatëse. Përveç njohurive teorike sesionet patën pjesë praktike me teknika Vetë-Mbrojtje (ESD- Empoëerment through Self-Defense) e cila u zhvillua nga një punonjëse e FGE e cila është instruktore e certifikuar e ESD.

Kohëzgjatja e sesionit **një orë** me një grup prej **20 – 25 pjesëmarrësish** (oficerët e sigurisë në shkolla, psikologët e shkollave dhe mësuesit e lëndëve shoqërore dhe edukimit fizik) dhe në një orar të përshtatshëm të vendosur bashkarisht për mos të çënuar procesin mësimor.

Për këte arsye ju kërkua bashkëpunimi i të gjithë Zyrave Arsimore Vendore në të shtata bashkitë e Qarkut Elbasan për realizimin sa më të mirë të këtij aktiviteti, në bazë të Autorizimit të marrë në Ministrinë e arsimit dhe Sportit



15.10.2021 Belsh Shkolla e Mesme



09.12.2021 Prenjas Shkolla e Mesme



15.12.2021 Librazhd Shkolla e Mesme



16.12.2021 Cerrik Shkolla e Mesme



17.12.2021 Gramsh Shkolla e Mesme



21.12.2021 Peqin Shkolla e Mesme

Trajnim me studentë të Universitetit Aleksandër Xhuvani në Elbasan përmes platformës online. Për çdo session kishte një axhendë për çështjet që do të trajtoheshin në trajnimin online me studentët. Më poshtë është një model për sesionin e parë. Informacion të detajuar do të gjeni në linkun më poshtë për secilin session të mbajtur.

Agjendë

Trajnim “Parandalimi i ngacmimit & abuzimit seksual nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.”

Programi Rajonal për Luftën e Dhunës ndaj Grave “Zbatojmë Standardet, Ndryshojmë Mendësitë”

Vendi: online, Zoom platform

21 Janar 2021

15.30-15.45	Regjistrimi i pjesëmarrësve / Mirëseardhja Gertjana Hasalla, FGE
	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i moderatorëve të trajnimit <i>INES LESKAJ, EKSPERTE GJINORE</i>

	<p><i>ILIRIAN GJONI, EKSPERT PËR BARAZINE GJINORE DHE SIGURINE ONLINE</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantim I qëllimeve dhe objektivave të trajnimit
15:45 – 16:15	<p>Hyrje, Sesioni 1 <i>Moderator, Z. Ilirian Gjoni</i> <i>Ekspert i Barazisë Gjinore dhe Sigurisë online</i></p>
	<ul style="list-style-type: none"> - Prezantohuni me një fjalë. - Qëllimi dhe objektivat e trajnimit - Pritshmëritë e pjesëmarrësve <p>Energizer - Duke e filluar ditën tuaj si ...</p>
16:15 – 16:20	Pushim i shkurtër
16:20 – 16:50	<p>Ngacmimet ne internet, rreziqet ne lundrimin online. <i>Moderator, Z. Ilirian Gjoni</i> <i>Ekspert i Barazisë Gjinore dhe Sigurisë online</i></p>
	<ul style="list-style-type: none"> a) Format e dhunes me baze gjinore b) Si te raportojne nje incident dhuna seksuale, ngacmimet, përndjekja dhe martesat e detyruara <p>Ku ta raportojme: Alo 116, Njesia e Mbrojtjes se Fëmijëve, SPZ, FGE, etj</p>
16:50 – 17:00	Diskutime/Mbyllja

Sesioni 1

Facebook: <https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2718270105102094>

Twitter: <https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1352321802744246276>

Sesioni 2

Facebook: <https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2721602091435562>

Twitter: <https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1354125695627227143>

Sesioni 3

Facebook: <https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2723478904581214>

Twitter: <https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1355152499741700098>

Sesioni 4

Facebook: <https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2726052640990507>

Twitter: <https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1356600959691030529>

Sesioni 5

Facebook: <https://www.facebook.com/forumigruaselbasan/posts/2727499604179144>

Twitter: <https://twitter.com/ForumigruasElba/status/1357366113588424708>

Sesioni 6

Facebook: <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2731519413777163>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiguasElba/status/1359570349801750529>

Sesioni 7

Facebook: <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2732833036979134>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiguasElba/status/1360272961316519937>

Sesioni 8

Facebook: <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2736092896653148>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiguasElba/status/1362071643586240516>

Sesioni 9

Facebook: <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2736800336582404>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiguasElba/status/1362438255963222018>

Sesioni 10

Facebook: <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2740186546243783>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiguasElba/status/1364255615116324867>

Sesioni 11

Facebook: <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2746212525641185>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiguasElba/status/1367520641562251265>

Sesioni 12

Facebook: <https://www.facebook.com/forumiguaselbasan/posts/2751128435149594>

Twitter: <https://twitter.com/ForumiguasElba/status/1370079821305380865>

Aktivitetet e realizuara gjatë periudhës 01 Qershor 2021 – 31 Dhjetor 2021 të projektit të policimit në komunitet janë:

Koordinimi me partnerët strategjikë të projektit: Pas miratimit të projektit nga programi SCAP, Forumi i Gruas Elbasan realizoi takime me të katër kryetarët e bashkive partnere në projekt Belsh, Librazhd, Gramsh dhe Peqin dhe Drejtorin e Drejtorisë së Policisë Vendore Elbasan, ku u bë një prezantim i shkurtër i projektit dhe u diskutua për mënyrat e bashkëpunimit operativ midis institucioneve.

Gjithashtu, Forumi i Gruas Elbasan në kuadër të një marrëveshje bashkëpunimi që ka me Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit përgatiti të gjithë dokumentat e nevojshme dhe *arriti të marrë autorizimin* për të realizuar fushatën e ndërgjegjësimit të projektit në fjalë me të rinjtë në shkollat 9-vjecare dhe të mesme në Qarkun Elbasan.

Mirëfunksionimi i mekanizmit të referimit në Bashkitë Belsh, Gramsh, Peqin dhe Librazhd, për këtë FGE ka mbështetur në mënyrë praktike të 4 MKR-të e të 4 Bashkive partnere në këtë projekt.

Mbledhje të Komitetit Drejtues (KD)

Për çdo bashki Partnere është parashikuar realizimi i një takimi të KD. Të katërt bashkitë partnere janë ndihmuar nga FGE me një draft-marrëveshje sipas kompetencave të reja të çdo anëtari përcaktuar nga VKM-ja e re e MKR-së. Gjatë kësaj faze të raportimit është

realizuar një KD në Bashkinë Librazhd, ku pas ngritjes së Mekanizmit të Referimit në vitin 2019 me mbështetje të programit SCPA Kryetari i Bashkisë Librazhd ka realizuar më datë 22 Dhjetor 2021 mbledhjen e komitetit drejtues. Në këto takime ishin të pranishëm **16 drejtues** (8 femra dhe 8 meshkuj) nga **11 institucione** vendore si Bashkia, Policia, Prokuroria, Përmbarimi, Shëndetësia, Shërbimi Social, Prefektura, Komunitetet Fetare Musliman dhe Ortodoks, etj.

Të gjithë drejtuesit e institucioneve anëtare të MKR-së firmosën marrëveshjen e re të bashkëpunimit dhe treguan angazhimin e tyre në luftën kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.



Aktiviteti 1.2 Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërdisciplinor (GTN)

Gjatë muajve Shtator – Tetor të vitit 2021 janë zhvilluar 4 takime të ETN-së, një takim për çdo bashki partnere në projekt, Bashkitë Belsh, Librazhd, Gramsh dhe Peqin. Kanë qënë të pranishëm **59 pjesëmarrës (39 femra dhe 20 meshkuj) në të katër takimet**, 16 pjesëmarrës në takimin e ETN-së organizuar në Bashkinë Gramsh, 15 në Bashkinë Belsh, 15 në Bashkinë Librazhd dhe 13 në Bashkinë Peqin.

Në Bashkinë Librazhd anëtarët e ETN-së i kërkuar drejtorit të shërbimit social të kësaj bashkie emërimin e një koordinatorë vendore të dhunës e cila është përgjegjëse për koordinimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës. Gjithashtu, edhe FGE ka lobuar me kryetarin e Bashkisë Librazhd për rëndësinë e emërimit të një koordinatorëje vendore të dhunës. Nga gjithë lobimi i realizuar në muajin Nëntor Bashkia Librazhd emëroi për herë të parë koordinatorën vendore të dhunës.



Trajnim me anëtarët e mekanizmit të referimit të dhunës në 4 bashkitë partnere.

Në kuadër të këtij projekti u organizua në muajin Shtator trajnimi një ditor me 19 përfaqësues (14 femra dhe 5 meshkuj) të institucioneve kryesore lokale anëtare të mekanizmit të referimit në të katër bashkitë partnere në projekt. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit u trajnuan rreth ndryshimeve të reja ligjore, identifikimin e hershëm të rasteve të dhunës, menaxhimin e suksesshëm të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, hartimin e planeve individuale të rasteve dhe monitorimi i UM-ve, si dhe ndarja e eksperiencave nga ana e përfaqësueseve të ETN-ve të 4 bashkive partnere. Trajnimi ishte interaktiv me prezantim të materialeve në ppt, pyetje, diskutime dhe punë në grupe. Nga përgjigjet e dhëna nga pjesëmarrësit në pyetësorin e vlerësimit të njohurive të marra gjatë trajnimit vlen të theksohet vlerësimi për trajnimin e realizuar dhe nevojën për realizimin e trajnimeve të tjera në të ardhmen.



Takime ndërgjegjëse me të rinjtë

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar **3 takime ndërgjegjëse me të rinjtë** e shkollës së mesme/9- vjecare Librazhd, Gramsh dhe Peqin. Në këto takime ishin të pranishëm **91 pjesëmarrës** (49 femra dhe 42 meshkuj). Të rinjtë janë ndërgjegjësuar mbi fenomenet e

dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore, sigurisë qytetare dhe partneritetit polici – qytetar. Gjatë takimeve janë përdorur metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse për të nxitur të rinjtë të ndërmarrin iniciativa në komunitetet ku jetojnë për të ndryshuar mendësitë e prapambetura dhe për të edukuar bashkëmoshatarët mbi rolet gjinore, barazinë gjinore dhe rëndësisë së partneritetit polici - qytetar.



Forume Publike

Gjatë kësaj periudhe të raportimit është realizuar **1 forum publik** me komunitetin në Bashkinë Librazhd. Në këtë takim kanë marrë pjesë **32 persona** (22 femra dhe 10 meshkuj) burra, gra, të rinj dhe përfaqësues të pushtetit vendor, si dhe monitoruesja e grantit SCPA.

Forumi publik u organizua në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Librazhd dhe Komisaratin e Policisë Librazhd. Në takim ishin të pranishëm përveç burrave, grave dhe të rinjve nga komuniteti edhe SPK-ja, koordinatoresha e dhunës, punonjësjë e NJMF-së, përfaqësues nga NJA, shkolla dhe qendrat shëndetsore. Në këtë takim u diskutua për rolin e policisë, rolin e institucioneve publike të pushtetit vendor, sfidat, problemet si dhe rëndësia e marrjes së përgjegjësisë nga të gjitha palët për një rend dhe siguri më të mirë.



Fushata e 16 ditëve kundër dhunës 2021

Së bashku me anëtarët e mekanizmit të referimit u punua nga muaji Shtator për përgatitjen e një Plani aktivitetesh të koordinuara për fushatën e 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës ndaj grave dhe vajzave në të katër bashkitë partnere.

Ndërsa në Elbasan u realizuan **3 kënde informuese në Shkollën e mesme “Kostandin Kristoforidhi”, “Dhaskal Todri” dhe në sheshin para Teatrit “Skampa”** nga dt. 25 deri në datën 10 Dhjetor. Aktiviteti u realizua nga Forumi i Gruas Elbasan në bashkëpunim me koordinatoren e dhunës në Bashkinë Elbasan, 2 Specialistët e Policimit në Komunitet, dhe 2 ndihmës Specialistët e rinj të Policimit në Komunitet dhe Zëdhënësen e shtypit të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan. Gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve u shpërndanë materiale ndërgjegjësimi të realizuara nga Programi SCAP posaçërisht për këtë fushatë dhe materiale të tjera të prodhuara në kuadër të projektit. U mbajtën takime ndërgjegjësimi në klasa më të rinj, ku u diskutuan sfidat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, roli i koordinatorit të dhunës, SPK-ve, NSPK dhe mekanizmi i referimit.

